



Kuvendi i Komunës Klinë

Nr. prot. 400-1367/2024

Datë: 05.06/2024

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronjën c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nenit 6 dhe paragrafit 6 të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024. Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Nenit 40 në pikën 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës: 13.05.2024 me nr. prot. 01Nr.401-15800/2024, si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 20.05.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt të mbajtur më datën: 30.05.2024, mori këtë :

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2023, dhe bartjen në vitin 2024, shuma prej **423,969.16 €**.
2. Shuma si në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahet në programe dhe nen-programe buxhetore dhe në kategori ekonomike të shpenzimeve si në vijim:
 - Mallra dhe Shërbime në shumën prej **65,000.00 €**;
 - Shpenzimet Komunale në shumën prej **20,000.00 €**;
 - Shpenzime Kapitale në shumën prej **338,969.16 €**.
3. **Në kategorinë mallra dhe shërbime :**
Infrastruktura Rrugore (18018), shuma prej 65,000.00 €;
Arsyetim: Mjetet e destinuara në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime, në shumën prej 65,000.00 €, do të përdoren për mirëmbajtjen e rrugëve lokale.
4. **Në kategorinë e shpenzimeve komunale :**
Drejtoria për Buxhet e Financa (17518), shuma prej 10,000.00 €;
Administrata e arsimit (92090) shuma prej 10,000.00 €.
Arsyetim: Mjetet e destinuara në kategorinë ekonomike të Shpenzimeve komunale, në shumën prej 20,000.00 €, do të përdoren për mbulimin e obligimeve të pashlyera për shkak të nxemjeve qendrore me pompa termike dhe rritja e tarifave për shërbimet e mbeturinave.

5. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

5.1. Planifikimi urban dhe inspeksion (66395), në projektet:

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Cerovik-Qabiq”, kodi (54276), shuma prej 3,186.17 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Sferkë -Volljakë-Qupevë”, kodi (54300), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i shtratit te Lumit Klina, Lagjia Arberi, Burimi i Jarines-Pograxhe”, kodi (54336), shuma prej 83,815.56 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Gjurgjevik te Madhe”, kodi (54337), shuma prej 20,000.00 €;

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore ne Poterq-Dugajevë-Drenovc”, kodi (54344), shuma prej 40,000.00€;

5.2. Infrastruktura Rrugore (18018), në projektet:

“Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujerave te zeza ne Zllakuqan, Jashanicë, Shtaricë, Gllarevë, Radulloç”, kodi (54516), shuma prej 71,967.43 €

5.3. Shërbimet Rezidenciale (75587), në projektet:

“Ndërtimi i shtëpisë se pleqëve ne Kline”, kodi (54463), shuma prej 100,000.00 €.

Arsyetim: Mjetet në kategorinë e shpenzimeve kapitale në shumën prej 338,969.16 €, do të përdorën për mbulimin e obligimeve kontraktuar, vazhdimin e projekteve të pa përfunduar.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryetari i komunës në bashkëpunim me drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
7. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi